

**AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI  
TE KUFIZUAR**

**"QUEEN DENTAL" SHPK**

**Neni 1**

**Emertimi i Shoqerise**

- 1.1 Shoqeria e emertuar "Queen Dental" Shpk (me poshte e quajtur "Queen Dental"), eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise.
- 1.2 Shoqeria eshte themeluar sipas ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe fiton personalitet juridik pas regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar Shqiptar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.
- 1.3 Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Statutin dhe Aktin e Themelimit.

**Neni 2**

**Selia**

1. 2.1 Selia qendrore e Shoqerise ndodhet ne adresen "Bulevardi Zhan Dark" Shkalla 2, Kati 1, ngjtur me Ministrine e Jashtme – Tirane. Zona Kadastrale B150, me numer pasurie 5/592+2-N10.
2. 2.2 Shoqeria mund te hape zyra perfaqesimi, dege dhe/ose filiale dhe/ose te marre pjese ne shoqeri te tjera, te kryeje aktivitet ne vende te tjera, qofte brenda apo jashte territorit te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me vendimet e Asamblese Pergjithshme te Ortakeve.



### Neni 3

#### Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

### Neni 4

#### Objekti

Objekti i Shoqerise eshte ushtrimi i cdo biznesi apo aktiviteti te ligjshem dhe angazhimi ne cdo veprimtari te ligjshme ose aktivitet te lejueshem nga legjislacioni shqiptar dhe per te cilat nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar themelohet sipas legjislacionit shqiptar, i cili here pas here mund te ndryshohet. Shoqeria Queen Dental do te merret me ushtrimin e aktivitetit privat ne fushen dentare, ekografi, laboratore dentare dhe mjekesore, si dhe aktivitete te ndryshme ne fushen e mjekesise estetike dhe stomatologjise. Nderhyrje dentare, ne te gjitha kategorite qe diploma e dentistit, dhe rregullorja e urdherit te dentistit shqiptar i jep te drejten ushtrimit te profesionit, si Kirurgji, Endodonci, Ortodonci, Konservativ, Protezike,estetike fytyre etj. Import-export per blerje dhe shitje me shumice dhe pakice te pajisjeve dhe materialeve dentare dhe mjekesore.

2.



## Neni 5

### Ortaket e Shoqerise

Ortaket e shoqerise jane:

- **Z. Edian GJONAJ, i biri i Lesh-it**, lindur më 17.04.1983, në MAT dhe banues në Tiranë Ruuga Avdyl Matoshi, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID nr personal I30417006S, zoterues i 1 (një) kuote te cilat perfaqesojne 50 % te kapitalit te Shoqerise.
- **Znj. Danida Liçka**, shtetase shqiptare, lindur ne Lushnje, Shqiperi, me 24.07.1987, banues ne Durres Prane Vila Zogu, mbajtes i kartes se identitetit me nr. I75427142P, zoterues i 1(një) kuote te cilat perfaqesojne 50 % te kapitalit te Shoqerise.

## Neni 6

### Kapitali themeltar



Kapitali i themeluar fillestar i Shoqerise eshte: 2,000,000 (dy milione leke) dhe eshte i ndare ne menyre te barabarte ne dy kuota, me nga 1,000,000 leke (nje milione leke) secila. Pjesmarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

B) Ortaket themelues jane: **Danida Liçka** zoterues e 1 kuote me vlere te pergjithshme 1,000,000 lekë ( nje milione leke) qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

**Edian Gjonaj**: zoterues e 1 kuote me vlere te pergjithshme 1,000,000 lekë (nje milione leke) qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

## Neni 7

### Transferimi i Kuotave

7.1 Kuotat jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie ose kur kalimi i kuotave behet ne favor te bashkeshortit(es), si dhe paraardhesve ose pasardhesve te drejtperdrejte te ortakut.

Ne rastin e transferimit te kuotave ne favor te te tretevete cilet nuk jane ortakete Shoqerise, ortaket e tjere kane te drejten e parablerejes mbi kuoten e cila transferohet.

Ortaku i cili ka per qellim te transferoje pjeserisht apo plotesisht pjesemarrjen e tij ne kapitalin e Shoqerise, duhet te njoftoje me ane te postes se regjistruar Administratorin e Shoqerise. Oferta mbi

transferimin e kuotave duhet te permbaje te dhenat personale/te dhenat e shoqerise se shitesitsi dhe kushtet dhe afatet e transferimit, veçanerisht çmimin dhe menyren e pageses. Administratori duhet te njoftoje ortakët e tjere qe kane te drejte te ushtrojne te drejten e parablerjes brenda 30 diteve nga marrja e njoftimit per transferimin. Çdo ortak i interesuar per te blere kuotat te cilat do te transferohen duhet te njoftoje Administratorin mbi vullnetin e tij per te ushtruar te drejten e parablerjes brenda 30 diteve nga marrja e njoftimit nga Administratorii Shoqerise. Kuotat objekt transferimi duhet t'i transferohen ortakut bleres brenda 30 diteve nga data ne te cilen Administratori i Shoqerise ka njoftuar ortakun transferues per pranimin e ofertes se tij, duke percaktuar aty edhe emrin e ortakut i cili ka pranuar oferten.

## Neni 8

### Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

#### 8.1 Funksioni dhe Kompetencat

- 8.1.1 Ne perputhje me legjislacionin shqiptar Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve kur thirret rregullisht, perfaqeson te gjithë ortakët e Shoqerise dhe eshte organi me i larte vendimmarres i kesaj te fundit. Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendime, por pa u kufizuar vetem ne sa me poshte:



- a. Percaktimin e politikave te veprimtarise se Shoqerise;
- b. Ndryshimin e Statutit;
- c. Emerimin dhe shkarkimin e Administratorit;
- d. Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. Percaktimin e shperblimeve per administratoret, likuiduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar;
- f. Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit te Shoqerise;
- g. Miratimin e pasqyrave financiare per llogarite vjetore, dhe te raporteve te administrimit dhe mbikeqyrjes;
- h. Miratimin e rregullave proçeduriale ne lidhje me mbledhjet e Asamblese se Ortakeve;
- i. Miratimin e shperndarjes se fitimit vjetor;
- j. Miratimin e skemes se kompensimit per Administratorin, likuiduesin dhe ekspertet kontabel;
- k. Ristrukturimin, prishjen, transformimin, bashkimin, likuidimin e Shoqerise ose riorganizimin e Shoqerise ne ndonje forme tjeter shoqerie;
- l. Marrja e te gjitha masave me qellim te sigurohet qe Shoqeria te kete kapital dhe asete te mjaftueshme per ushtrimin e veprimtarise dhe permbushjen e detyrimeve kundrejt te treteve;
- m. Blerjen e kuotave ne shoqeri te tjera ose transferimin e kuotave te Shoqerise ose te kuotave qe kjo e fundit zoteron ne shoqeri te tjera me objekt aktiviteti te ngjashem;



- n. perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- o. Krijimin, mbylljen dhe prishjen e degeve, zyrave te perfaqesimit dhe filialeve;
- p. Autorizimin e cdo transaksioni nepermjet te cilit debitohen llogarite bankare dhe/ose te ardhurat e Shoqerise (duke perfshire transferimet e fondeve dhe/ose terheqjet ne cash) i cili tejkalon shumen 5000 (pese mije) Euro.
- q. çdo çështje tjeter te parashikuar nga ligji ose ky Statut.

#### Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme

Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet dhe vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve duke patur drejten e votes ne raport me numrin e kuotave te zoteruara ne kapitalin e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme te Ortakeve mblidhet sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve thirret te pakten nje here ne vitbrenda 6 muajve nga perfundimi i vitit ushtrimor. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve thirret nga administratoret ose nga ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne Asamblene e Pergjithshme te Shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve thirret nese:

1. sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

2. shoqeria propozon te shese apo te dispoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
3. shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

#### Menyra e thirrjesse Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve

Asambleja e Pergjithshme thirret nga administratori sipas gjykimit te tij te lire, ose me kerkesen e nje dhe/ose me shume ortakeve te cilet perfaqesojne te pakten 5 % te kapitalit te Shoqerise dhe/ose eksperti kontabel i autorizuar nese ka, dhe/ose likuiduesit.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve thirret nepermjet nje njoftimi me shkrim ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrim apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites dhe duhet ti dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per Mbledhjen e Asamblese se Ortakeve.

Kur Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve nuk eshte thirrur si me siper, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortakët jane dakord per te marre vendime pavaresisht parregullsisë.

#### Kuorumi i nevojshem dhe marrja e vendimeve





Çdo ortak mund te perfaqesohet ne vendimarrje nga nje perfaqesues i autorizuar me prokure per ate qellim. Administratorii shoqerise nuk mund te jete perfaqesues i ortakeve ne mbledhjet e Asamblese se Ortakeve.

Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendime te vlefshme kur jane te pranishem ortaket qe perfaqesojne me shume se 30% e kapitalit themeltar.

Ne rast se Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ceshtje te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese votojne ortaket e pranishem personalisht qe zoterojne me shume se  $\frac{1}{2}$  e numrit total te votave.

Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakevenuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se shumices se permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 diteme te njejtin rend dite.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve vendos me  $\frac{3}{4}$  e votave te ortakeve pjesemarrës për: (i) ndryshimin e statutit; (ii) zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar; (iii) shpërndarjen e fitimeve; (iv) riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.

#### Procesverbali i Mbledhjes se Asamblese se Ortakeve

Te gjitha vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratori pergjigjet per ruajtjen e kopjeve te procesverbaleve te mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.



Procesverballi duhet te permbaje daten e vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetarit e te mbajtesit te procesverballit, rezultatet e votimit.

Procesverballit i bashkelidhet edhe lista e pjesemarrresve si dhe akti i thirrjes se Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

Procesverballi i mbledhjes nenshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtesi i procesverballit.

#### 8.6 Konsultimi me shkrim.

Nese nuk parashikohet ndryshe nga ligji ose dokumentat e themelimit, çdo veprim i cili duhet te ndermerret nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te behet pa mbledhje dhe pa votim nese per kete veprim do te behet nje konsultim me shkrim i cili duhet te percaktoje veprimet e ndermarra dhe do te nenshkruhet nga te gjithë ortaket e Shoqerise.

### Neni 9

#### Administrimi i Shoqerise

##### 9.1 Funksionet dhe Kompetencat

9.1.1 **Z. Edian GJONAJ, i biri Llesh-it**, lindur më 17.04.11983, ne Mat dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të



vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID nr personal I30417006S.

Administratori emerohet për një periudhë kohore jo më të gjatë se 5 (pese) vjet, me të drejtë ri-emerimi.

Administratori do të jetë përgjegjës për administrimin e Shoqerisë dhe do të përfaqësojë Shoqerinë kundrejt paleve të treta në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe/ose të ligjit të zbatueshëm. Administratori ka kompetencë të plotë për të marrë vendime të zakonshme dhe të jashtëzakonshme për administrimin e Shoqerisë, përveç kompetencave që do të ushtrohen nga organe të tjera të Shoqerisë sipas këtij Statuti ose ligjit(eve) të zbatueshëm.

Administratori do të ketë këto kompetencë dhe detyra që lidhen me administrimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së Shoqerisë si më poshtë:

- (a) të mbikëqyrë dhe të zbatojë politikën tregtare të Shoqerisë dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- (b) me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, të ndermarre masat të cilat janë kompetencë e tij, të propozojë vendimet që do të miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve dhe t'i zbatojnë këto vendime;
- (c) të sigurojë që Shoqëria respekton ligjin(et) e zbatueshëm dhe standardet kontabel;
- (d) të kryejë të gjitha veprimet në lidhje me administrimin e veprimtarisë tregtare të Shoqerisë;
- (e) të përfaqësojë Shoqerinë kundrejt paleve të treta;
- (f) të sigurojë që dokumentet dhe librat kontabel të Shoqerisë të mbahen rregullisht;



- (g) Te therrase mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, nese e vlereson te nevojshme per mbrojtjen e interesave te Shoqerise;
- (h) Te pergatite dhe nenshkruaje pasqyrat financiare vjetore te Shoqerise, pasqyrat financiare te konsoliduara, te cilat bashke me propozimin per shperndarjen e fitimit i paraqiten per miratim Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.
- (i) Te kryeje te gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme ne lidhje me Shoqerine sipas parashikimeve te ligjite zbatueshem;
- (j) t'i raportoje Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe kryerjen e veprimtarive tregtare qe mund te konsiderohen me rendesi te veçante per Shoqerine;
- (k) Te miratoje hapjen e çdo procedure ligjore ose mbylljen e tyre;
- (l) te kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

9.1.4 Administratori mund te ushtroje te gjitha kompetencat si dhe te kryeje te gjitha veprimet te cilat me ligj apo ne ndonje menyre tjeter nuk i rezervohen kompetencave te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeveose nuk kufizohen nga ky statut apo nga ligji i zbatueshem.

9.1.5 Administratori mund te kryeje transaksione duke debituar llogarite dhe/ose te ardhurat e shoqerise (duke perfshire transferimet e fondeve dhe/ose terheqjet ne cash) deri ne shumen 5000 Euro (pesemije euro)duke mos tejkualuar kete shume.

9.2. Pergjegjesite.



Administratorieshte individualishtpergjegjes kundrejt Shoqerise dhe/ose paleve te treta per demet e shkaktuara nga shkelja e dispozitavete ketij statuti ose e ligjeve te zbatueshme.

## Neni 10

### Ekspert(et) Kontabel te Autorizuar

Eksperti(et) kontabel te autorizuar do te emerohet(n) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne rastet kur kjo eshte kerkese elegjislacionit shqiptar. Riemerimi e ekspertit(ve) kontabel te autorizuar do te behet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Eksperti(et) kontabel te autorizuar mund te shkarkohen me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne rast te shkeljeve te detyrave, gabimeve dhe sjelljes jo te mire profesionale.

## Neni 11

### Viti Financiar

Viti Financiar fillon ne 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht, viti i pare ushtrimor fillon me daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe perfundon me date 31 Dhjetor 2010.



## Neni 12

### Shperndarja dhe Prishja

- 12.1 Shoqeria mund te shperndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve. Shperndarja e shoqerise do te ndiqet nga prishja e saj.
- 12.2 Shoqeria do te ruaje personalitetin juridik, i cili do te sherbeje per qellimet e likuidimit. Gjate likuidimit, emrin e shoqerise do ta pasojne fjalet "ne proces likuidimi"
- 12.3 Likuidatori(et) do te emerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve. Prishja e Shoqerise dhe emerimi i likuidatorit(ve) do te kryhet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

## Neni 13

### Ligji i Zbatueshem

- 13.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe me ligjin shqiptar.
- 13.2 Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut, do te aplikohen dispozitat e ligjit shqiptar per shoqerite tregtare.



## Neni 14

### Mosmarreveshjet

Per çdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij statuti dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde ndermjet Shoqerise dhe paleve te treta, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jene gjykatat shqiptare.

## Neni 15

### Ndryshimet

Ky statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendesohet me nje statut te ri me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

Ky statut i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Queen Dental" Shpk. hartohet ne 4 kopje ne gjuhen shqipe dhe ne kater kopje ne gjuhen angleze me vlere te njejte secila.

## ORTAKET



**Edian GJONAJ**

Edian Gjona  
2024

**Danida LICKA**

Danida Licka

Data 20/03/2024